

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6397  
E enjte, 26 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

## ShBA-ja, 3.8 milionë dollarë shtesë për Kosovën



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

GJASHTË VJET NGA ARRITJA E MARRËVESHJES PËR ASOCIACIONIN KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË BRUKSEL | FAQE 4-5

# PËR GJASHTË VJET KOSOVA NË KURTHIN E ASOCIACIONIT



Kanë kaluar gjashtë vjet që prej nënshkrimit në Bruksel të marrëveshjes për asociacionin e komunave me shumicë serbe, por ende kjo ujdë nuk është zbatuar. Pasi

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kjo marrëveshje është antikushtetuese, Kosova ka hezitur ta zbatojë, ndërsa bashkësia ndërkombëtare vazhdimisht ia ka

kujuar Kosovës këtë obligim ndërkombëtar. Njohësit e proceseve politike në vend kanë vlerësuar se Kosova që gjashtë vjet vazhdon të jetë e ngujuar në kurthin e asociacionit

## Qeveria ndan mbi 40 milionë euro për zbatimin e masave të pakos së ringjalljes ekonomike | FAQE 8



## Fillimi i vitit të ri shkollor, më 1 shtator, me prani fizike në shkolla | FAQE 2

### AKTUALE



### NJË MUAJ PARABURGIM PËR DARDAN KRIVAQËN | F.7

### PUNËTORËT SHËNDETËSORË, TË PAKËNAQUR ME NDIHMËN E QEVERISË | F.5

### PËRURORHET KOMPLEKSI "KODRA E UÇK-SË" NË NGUCAT | F.7



### EKONOMI

### ENA DHE AKADEMIJA DIPLOMATIKE ORGANIZOJNË TRAJNIM PËR DIPLOMACI EKONOMIKE DHE PUBLIKE | F.8

### SPORT

### KRASNIQI: E KEMI HARRUAR BARAZIMIN ME MALISHEVËN, PËR FITORE NDAJ BALLKANIT | F.12



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kosova do të strehojë rreth 2 000 afganë



PRISHTINË, 25 GUSHT - Rreth 2 000 shtetas afganë pritet të vijnë në Kosovë ka bërë me dije ministri i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, Xhelal Sveçla. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Sveçla ka thënë se për ardhjen e afganëve, institucionet e Kosovës po koordinohen

rregullisht me aleatët amerikanë në Afganistan, NATO e në Kosovë. Sipas tij, qëndrimi i personave që do të vijnë nga Afganistani nuk do të jetë i gjatë dhe, siç ka thënë ai, Kosova mund t'u ofrojë atyre mbrojtje të përkohshme në kohëzgjatje prej një viti. "Ne jemi duke biseduar me

partnerët tanë për t'i parë nevojat e afganëve për strehim, pastaj për të kalkuluar edhe potencialin apo mundësitë e shtetit të Kosovës për t'i strehuar ata. Numri për të cilin po flasim, dhe gjithmonë po flasim për strehim të përkohshëm, është rreth 2 000", ka thënë ai.

## Fillimi i vitit të ri shkollor, më 1 shtator, me prani fizike në shkolla

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 GUSHT - Për të diskutuar për përgatitjet që janë bërë për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022, të mërkurën është mbajtur takimi i Kolegjiut për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës me drejtorët komunalë të arsimit, e ku ka marrë pjesë ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci. Në këtë takim u konkludua se janë bërë të gjitha përgatitjet nga ana e komunave të Kosovës dhe ministrisë në mënyrë që viti i ri shkollor të fillojë më 1 shtator me prani fizike në shkollë. Ministrja Nagavci ka theksuar se MSh-ja dhe IKShPK-ja rekomandojnë që ky vit shkollor të fillojë me prani fizike në shkollë. Ajo i informoi drejtorët komunalë të arsimit për përgatitjet që janë bërë nga ana e ministrisë për fillimin e vitit shkollor.

Ndër të tjera, ministrja ka thënë se tashmë ka filluar shpërndarja e teksteve shkollore dhe shumë shpejt DKA-të do të kenë edhe protokollet dhe udhëzuesin e rishikuar për organizimin e mësimin në kushte të pandemisë.

Ministrja Nagavci ka falënderuar drejtorët komunalë, por edhe të gjithë aktorët e tjerë që menaxhojnë situatën pandemike, për punën që kanë



bërë deri më tani. Por, ajo theksoi nevojën e bashkëpunimit edhe më të shtuar për fillim të këtij viti shkollor, duke pasur parasysh situatën pandemike në vend.

Ministrja Nagavci, po ashtu, u bëri thirrje edhe mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve që të kujdesen maksimalisht, duke zbatuar

masat e rekomanduara nga Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK.

Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimimi dhe kryetari i Kolegjiut për Arsim, Besim Avdimetaj, theksuan se është lajm i mirë fillimi i vitit shkollor me prani në shkollë.

Ndërsa drejtorët e DKA-ve thanë

se shkollat janë përgatitur për fillim të vitit shkollor ndërsa, sipas statistikave që ata paraqitën, mesatarja e personelit arsimor të vaksinuar me njërin dhe me të dyja dozat e vaksinës është rreth 70 për qind deri më tani. Drejtorët e DKA-ve, po ashtu, kanë paraqitur disa vështirësi rreth çështjes së rekrutimit të stafit, si dhe

vështirësitë që po krijojnë obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive.

Ky takim është zhvilluar pas takimit që ka pasur të mërkurën ministrja Nagavci me përfaqësues të MSh-së, të IKShPK-së dhe të UNICEF-it, ku është biseduar rreth masave kundër pandemisë që duhet të zbatohen në shkolla.

## Kosova dhe Maqedonia shtojnë bashkëpunimin

Shkup, 25 gusht (ER) - Në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, u prit të mërkurën nga homologia e tij, Radmila Shekerinska-Jankovska, me nderimet më të larta ushtarake. Më pas, të dy ministrat zhvilluan takimin sy më sy, për të vazhduar më tej në nivel të delegacioneve zyrtare.

Gjatë kësaj vizite të dy ministrat nënshkruan marrëveshje bilaterale kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave, që nënkupton organizimin e trajnimeve nga PARC për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në.

Në konferencën e organizuar për media të dy ministrat theksuan bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të deritashëm

dhe zotimin e tyre që ky bashkëpunim të shtohet edhe më tej në interes të të dyja vendeve fqinjesi dhe në interes të sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.

Më pas, ministri Mehaj u prit nga kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe dekani i Akademisë Ushtarake, prof. dr. Mitko Bogdanovski.



# OJQ-të kërkojnë depolitizimin e çështjes së personave të pagjetur

PRISHTINË, 25 GUSHT - Organizatat që merren me çështjen e të pagjeturve nga lufta e fundit në Kosovë kërkojnë që kjo çështje të depolitizohet. Dhimbja e cila po përcjell këto familje tani e 22 vjet vlerësohet të jetë keqpërdorur nga politika dhe politikanët për përfitime të tyre. Kështu u tha në forumin “Nevoja për depolitizimin e çështjes së personave të zhdukur”, të mbajtur të mërkurën në Prishtinë, nën organizimin e Qendrës Burimore për Personat e Zhdukur.

Ky forum po organizohet në prag të Ditës Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve me Forcë e cila shënohet më 30 gusht.

Bajram Qerkini, drejtues i shoqatës “Zëri i Prindërve”, shoqatë kjo e familjarëve të personave të pagjetur në Kosovë, thotë se të gjithë familjarët e personave të pagjetur duan që kjo çështje humanitare të depolitizohet. “Ju ndërkombehtarët dhe qeveritarët

nuk mund të na shëroni, por mund të na zbutni dhimbjen që e kemi plot 22 vjet. Më çka? Me punët që i keni premtuar e që nuk po i kryeni. Kërkesa e familjarëve është një, zbardhja e fatit të të pagjeturve”, ka thënë ai. Në anën tjetër, ambasadori i Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, i pranishëm në këtë forum, ka theksuar se çështja e vuajtjeve njerëzore, siç është çështja e personave të pagjetur, nuk duhet të politizohet. Sipas tij, kjo nuk do të thotë të injorohet mjedisi politik në të cilin këto çështje zhvillohen, por kjo do të thotë që askush nuk duhet ta përdorë çështjen e të zhdukurve si një përfitim politik. Ai ka shtuar se Kosova dhe Serbia duhet të komunikojnë për të ndarë informata në mënyrë të hapur dhe në një frymë të bashkëpunimit dhe jo përplasjeje. “Personat e zhdukur, familjet e tyre dhe organizatat joqeveritare që mbështesin këtë, nuk duhet të përdoren si futboll në arenën politike të



normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka deklaruar Abbott.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999 rezultuan

rreth 6 500 persona të zhdukur. Që nga ajo kohë u kryen zhvarrime në varreza masive në Kosovë dhe Serbi dhe deri më tani janë gjetur rreth 70 për qind

e të zhdukurve. Sipas autoriteteve në Kosovë, ende vazhdojnë të rezultojnë të pagjetur rreth 1 600 persona, kryesisht shqiptarë.

## ShBA-ja, 3.8 milionë dollarë shtesë për Kosovën

EPOKA  
ERE

### Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nënshkruar sot amendamentin 2 të Marrëveshjes së Grantit për Objektivat Zhvillimore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin Republika e Kosovës përfiton edhe 3.8 milionë dollarë shtesë. Kjo marrëveshje fillimisht ishte nënshkruar në nëntor të

vitit 2020, me të cilën Republika e Kosovës ka përfituar 33 milionë dollarë nga USAID-i. Në maj të këtij viti u nënshkrua amendamenti 1 i marrëveshjes, i cili i siguron Republikës së Kosovës një shtesë të mjeteve financiare në shumën prej 1.6 milion dollarësh amerikanë. Kurse sot, me amendamentin 2 të kësaj marrëveshjeje, Republika e Kosovës përfiton edhe 3.8 milionë dollarë shtesë,

duke e rritur vlerën totale të marrëveshjes në 38.4 milionë dollarë.

Me këtë marrëveshje synohet shërbimi më i mirë ndaj qytetarëve nga institucionet llogaridhënëse dhe efektive të qeverisjes, si dhe rritja e mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike.

Objektivi i parë zhvillimor i marrëveshjes përqendrohet në

mbikëqyrjen e institucioneve nga ana e qytetarëve dhe shoqërisë civile, ndërsa i dyti adopton një qasje më të gjerë ndaj pjesëmarrjes demokratike. Me të synohet përmirësimi dhe bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve, shoqërisë civile, bizneseve dhe sektorit publik në mënyrë që komunitetet lokale të kenë pozicion më të favorshëm për t'i adresuar sfidat zhvillimore të Kosovës.

Presidentja Osmani ka falënderuar për mbështetjen drejtoreshën e re të USAID-it në Kosovë, Zeinah Salahi, njëkohësisht e ka uruar për detyrën.

Osmani ka potencuar rëndësinë e angazhimit të USAID-it në Republikën e Kosovës në zhvillimin e shoqërisë, si dhe mbështetjen e fuqishme të ShBA-së ndaj Republikës së Kosovës.



GJASHTË VJET NGA ARRITJA E MARRËVESHJES PËR ASOCIACIONIN KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË BRUKSEL

# Për gjashtë vjet Kosova në kurthin e asociacionit

Kanë kaluar gjashtë vjet që prej nënshkrimit të marrëveshjes për asociacionin e komunave me shumicë serbe në Bruksel, por ende kjo ujdi nuk është zbatuar. Pasi Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kjo marrëveshje është antikushtetuese, Kosova ka hezitur ta zbatojë, ndërsa bashkësia ndërkombëtare vazhdimisht ia ka kujtuar Kosovës këtë obligim ndërkombëtar. Njohësit e proceseve politike në vend kanë vlerësuar se Kosova që gjashtë vjet vazhdon të jetë e ngujuar në kurthin e asociacionit

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Janë bërë gjashtë vjet nga arritja e Marrëveshjes mbi Parimet e Përgjithshme të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por palët ende nuk kanë arritur ta gjejnë një zgjidhje për zbatimin e saj. Cilësimi i kësaj marrëveshje si jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka bërë që institucionet e Kosovës të mos e zbatojnë këtë marrëveshje, kurse Serbia vazhdimisht ka insistuar në zbatimin e marrëveshjeve bërë më 25 gusht të vitit 2015.

Në bisedimet që janë bërë për këtë çështje në Bruksel, Kosova ka kundërshtuar pretendimet e Serbisë që ky asociacion të ketë

kompetenca ekzekutive.

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, i cili e ka nënshkruar këtë marrëveshje, ka thënë se asociacioni i komunave me shumicë serbe do të ishte jokushtetues nëse do të kishte kompetenca ekzekutive. "Në rast se asociacioni i komunave me shumicë serbe do të kishte kompetenca ekzekutive, ai do të bëhej pushtet i tretë dhe, si i tillë, është jokushtetues dhe i papranueshëm", është shprehur Mustafa për "FrontaOnline".

Ai nuk pret që kjo marrëveshje të zbatohet nga kryeministri aktual Albin Kurti. "Kundërshtimi i asociacionit dhe i dialogut me Serbinë e ka sjellë Albin Kurtin në pushtet. Prandaj do të ishte e panatyrshme që ai ta pranojë asociacionin", ka deklaruar ai, duke shtuar se nuk sheh vullnet të palëve për një marrëveshje

përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nuk po vërej përkushtim as nga faktori ndërkombëtar. Nuk ka ide dhe strategji për dialogun në Kosovë nga asnjë organ, qoftë nga qeveria, parlamenti apo presidenca. Të gjithë po kënaqen se 'ia thamë të tërat Serbisë' por, në fakt, Serbia po fiton përkrahje ndërkombëtare, kurse ne jemi dehur në romantizmin lokal politik", është shprehur Mustafa.

Ndërsa analisti politik Imer Mushkolaj ka vlerësuar se Kosova që gjashtë vjet është ngujuar në kurthin e asociacionit. "Sot gjashtë vjet në Bruksel u nënshkrua marrëveshja për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Isa Mustafa e Hashim Thaçi thanë atëherë se asociacioni nuk do të ketë asnjë

kompetencë ekzekutive. Gjykata Kushtetuese vlerësoi ndryshe. Tash gjashtë vjet vazhdojmë të jemi të ngujuar në kurthin e asociacionit", ka shkruar Mushkolaj në profilin e vet në "Facebook".

## Asociacioni, obligim ndërkombëtar i Kosovës

Pavarësisht prej kundërshtimeve të institucioneve të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare ka insistuar se marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe është obligim të cilin e kanë marrë institucionet e Kosovës dhe duhet ta zbatojnë. Së fundmi ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ua ka kujtuar institucioneve të Kosovës këtë obligim ndërkombëtar. "Shtetet e Bashkuara besojnë se Kosova e ka detyrim ta formojë asociacionin e komunave me shumicë serbe", ka deklaruar Kosnett. Ai ka vlerësuar se historia nuk fillon në ditën kur është formuar qeveria e Albin Kurtit. "Ne besojmë se vendet e kanë detyrim t'i respektojnë marrëveshjet dhe obligimet e ndërmara më parë",

ka deklaruar diplomati amerikan.

Mirëpo kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se në Kosovë nuk mund të formohet asociacion njëetnik. "Nuk mendoj se është e mundshme në rendin juridik dhe kushtetues të Kosovës të ketë asociacion mbi baza etnike. Mund të ketë asociacion të komunave mbi baza zhvillimore, mund të ketë mbi baza gjeografike, ta zëmë asociacion të bjeshkëve të Rugovës, të Maleve të Sharrit ose të Lumit Lepenc. Por, Asociacion mbi bazë etnike nuk mund të kalojë as sa i përket frymës e as germës së Kushtetutës së Kosovës", ka deklaruar Kurti.

Marrëveshja për asociacionin ishte arritur ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa dhe kryeministrit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në kuadër të dialogut të Brukselit. Pas kundërshtimeve të shumta nga opozita, më 31 tetor 2015, marrëveshja ishte dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese nga presidentja Atifete Jahjaga. Gjykata në aktgjykimin e nxjerrë më 23 dhjetor të atij viti kishte konstatuar se asnjë nga parimet e marrëveshjes nuk është tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës.

# 14 viktima dhe mbi 2 500 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë raportuar 14 raste të të vdekurve nga Covid-19. Gjatë kësaj periudhe kohore 2 541 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. "Nga 12 618 testime, 2 541 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 14 raste të vdekjes. Sot janë shëruar 604 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 108 603. Në total numri i rasteve aktive është 23 845", ka njoftuar MSh-ja.

Gjithashtu, kjo ministri ka njoftuar edhe për procesin e vaksinimit në 24 orët e fundit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 18 326 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 747 898 doza të vaksinës. Deri më sot 250 626 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është thënë në njoftimin e MSh-së.

Rritja e numrit të vdekjeve nga

Covidi në vend ka nxitur reagime të ndryshme, duke e akuzuar qeverinë për dështim në menaxhimin e pandemisë. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kosova është vend i vogël për t'i pasur 44 vdekje për tri ditë nga ky virus. "Jemi vend i vogël për t'i përballuar si hijëgjë 44 tragjedi familjare nëpër Kosovë. Katër të rinj e reja, në të njëzetat, janë shuar për tri ditë nga varianti i ri. Nga një ditë zie e kemi çdo ditë. Këtë gjendje shqetësuese s'mund ta normalizojmë. S'është normale. As ta politizojmë sepse në beteja si këto, as që dua të marr ndonjë votë. Por s'mund të sillemi sikurse nuk po ndodh asgjë. S'mund t'i kapërcejmë gjithë këto vdekje tragjike vetëm si numra qa na shpërfaqen në orën tre e gjysmë", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, qeveria po sillet sikurse nuk po ndodh asgjë.

Edhe analisti Albert Krasniqi ka theksuar se qeveria ka dështuar ta menaxhojë



pandeminë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se Kosova është vendi i dytë në botë me më së shumti raste të reja në 100 mijë banorë. "Për vetëm një javë janë regjistruar 13 956 raste të reja me Covid-19, prej të cilëve 75 persona

kanë humbur jetën. Kosova është vendi i dytë në botë për më së shumti raste të reja në 100 mijë banorë dhe është në mesin e pesë vendeve me rrezikshmërinë më të lartë për të udhëtuar. Krejt këtu erdhëm nga dështimi i qeverisë për ta

menaxhuar pandeminë. Asnjë masë! U soll thuajse nuk ka pandemi. Një dyqan tregtar, 'Zara', u soll më me përgjegjësi ndaj klientëve të vet duke kërkuar vendosjen e masave sesa qeveria ndaj qytetarëve të saj", ka shkruar Krasniqi.



## Punëtorët shëndetësorë të pakënaqur me ndihmën e qeverisë

PRISHTINË, 25 GUSHT - Federata Sindikale e Shëndetësisë (FSSH) e ka quajtur skandaloz vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagës prej 10-përqindësh të pagës bruto për tre muaj për punëtorët shëndetësorë. Blerim Sylja, kryetar i kësaj sindikate, vendimin e qeverisë e quan ofendues për personelin shëndetësor.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e fundit të

mbajtur të mërkurën ka ndarë 2.7 milionë euro mbështetje për stafin mjekësor në sektorin publik, pagë shtesë prej 10-përqindësh të pagës së rregullt bruto, jo më pak se 60 euro, për muajt gusht, shtator dhe tetor të vitit 2021.

Zbatimi i kësaj mase, thuhet në komunikatë të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, "është tejet i rëndësishëm në vazhdimin e luftimit të pandemisë, veçanërisht tani

kur vendi është në fazën e vaksinimit masiv". "Ata kanë shkelur ligjin, ata nuk kanë dhënë shtesat minimale nga muaji qershor dhe korrik, e tash në prag të zgjedhjeve lokale kishe marrin vendime. Unë personalisht po mendoj se shumica e punëtorëve mendojnë këtë. Do të ishte më e rrugës që mos t'i japin këto shtesa fare dhe mos të dalin në sy të popullit se kinse po japin shtesa për punëtorët shëndetësorë", ka thënë Sylja

për "Radion Evropa e Lirë". Sylja ka shtuar se ky vendim është demotivues për punëtorët shëndetësorë në kohën kur janë ndërprerë edhe pushimet vjetore të stafit shëndetësor. "Vetëm po e paralajmëroj se shtatori nuk do të jetë i qetë sa iu përket anëtarëve të FSSH-së. Se çfarë vendime do të marrim nuk e di, por e di që vendimet do të jenë mjaft radikale, duke pasur kujdes në ruajtjen e popullatës dhe shëndetin e

saj", ka thënë ai.

Për shkak të rritjes së numrit të personave të infektuar me Covid-19, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka ndërprerë dhënien e disa shërbimeve spitalore jorgjente në sallat kirurgjike dhe pushimet vjetore të stafit shëndetësor. Në sektorin publik paga mujore e mjekut është rreth 600 euro në muaj, kurse infermierët për punën e tyre paguhen rreth 400 euro.

## Malisheva harton draftstrategji kundër dhunës në familje

**MALISHEVË, 25 GUSHT (ER)** - Pas inicimit për hartimin e draftstrategjisë kundër dhunës në familje, nga zyrtarja për Barazi Gjinore në komunën e Malishevës, Vera Bytyçi, si dhe pas shumë aktiviteteve me shumë institucione përkatëse, organizata joqeveritare, shkolla brenda territorit të

komunës së Malishevës dhe regionit të Gjakovës, u formua grupi punues i cili hartoi draftstrategjinë kundër dhunës në familje. Ky grup ka mbajtur disa punëtori në Malishevë dhe Gjakovë, ku ka gjetur mbështetje edhe nga OSBE-ja. Një takim i tillë për këtë dokument u mbajt edhe të

mërkurën, ku u plotësuan edhe disa çështje, më pas kjo draftstrategji do të rekomandohet për Kuvendin e Komunës së Malishevës për konsultimin e parë publik. Draftstrategjia kundër dhunës në familje ka edhe planin e veprimit si dhe buxhetin që parashihet në implementimin e saj.



## Vihet gurthemeli i urës që lidh qytetarët e Kamenicës me ata të Luginës

**KAMENICË, 25 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me kryetarin e komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, kanë vendosur gurthemelin e urës në fshatin Breznicës, e cila lidh qytetarët e Kamenicës me ata të Bujanocit dhe të Luginës së Preshevës.

Kastrati ka thënë se me ndërtimin e kësaj ure do të lehtësohet qarkullimi i qytetarëve të Kamenicës dhe atyre të Bujanocit dhe Luginës së Preshevës. “Sot për mua është një nga momentet dhe emocionet më të veçanta ku sot dy komuna nga shtete të

ndryshme po arrijnë të ndërtojnë një urë për krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e kësaj pjese. Shpresojmë se ky do të jetë vetëm një nga investimet e para në mes të komunave”, ka thënë ai.

Kastrati ka premtuar se projektet e përbashkëta do të vazhdojnë përsëri dhe se për këtë projekt kanë kërkuar edhe ndihmën e qeverisë.

Edhe kryetari i Bujanocit, Nagip Arifi, ka thënë se ndihet i lumtur që për herë të parë po e realizojnë një projekt të përbashkët me komunën e Kamenicës. “Jam shumë i lumtur që për herë të parë po realizojmë



një projekt të përbashkët me komunën e Kamenicës. Kjo urë nuk do t'i lidhë vetëm dy fshatra, por do të lidhë dy komuna dhe dy shtete. Kjo është arsyeja se pse ka një rëndësi të posaçme ky projekt i përbashkët. Së bashku me kryetarin Kastrati do ta vazhdojmë realizimin e projekteve të tjera që qytetarët ta kenë jetën më të mirë, lirë të dhe më me perspektivë”, ka deklaruar Arifi.

Ky projekt i realizuar në mes të dy komunave kap vlerën mbi 52 mijë euro, prej të cilave 41 mijë euro janë investuar nga komuna e Kamenicës dhe pjesa tjetër nga komuna e Bujanocit.

## Komuna e Mitrovicës subvencionon me rotofreza 55 fermerë



**MITROVICË, 25 GUSHT (ER)** - Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën e Mitrovicës, në kuadër të planit të saj të punës, ka subvencionuar me rotofreza 55 fermerë. Të pranishëm në rastin e nënshkrimit të kontratave me fermerët përfitues të projektit ishin kryetari i komunës Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, si dhe drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku. Në fjalën e tij, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, fillimisht përshëndeti të gjithë fermerët

duke i vlerësuar si punëtorë të zellshëm, ku falë punës së tyre sektori i bujqësisë po shënon edhe përparim. “Shpreh mirënjohjen time për punën tuaj të zellshme si dhe për bashkëpunimin tuaj me Drejtorinë e Bujqësisë, ku së bashku janë realizuar shumë projekte, në sektorë të ndryshëm, përmes subvencionimit nga ana e komunës”, ka thënë Bahtiri. Ai ka uruar të gjithë fermerët përfitues të këtij projekti, duke u dëshiruar suksese në punën e tyre edhe në të ardhmen.

Ndërsa drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, ka thënë se drejtoria që drejton në vazhdimësi ka mbështetur fermerët për zhvillimin e veprimtarive të tyre, duke ua lehtësuar kështu edhe kushtet e jetës. Nga ky projekt janë mbështetur gjithsej 55 fermerë me rotofreza. Vlera totale e projektit arrin shumën 44 825.00 euro, prej tyre participimi i fermerëve është 30 për qind, ndërsa komuna e Mitrovicës ka ndarë mjete në vlerë prej 31.377.00 eurosh.

## Lladrovci viziton qendrën e vaksinimit, bën thirrje për vaksinim

**DRENAS, 25 GUSHT (ER)** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu, kanë vizituar qendrën e vaksinimit, ku kanë takuar mjekët dhe infermierët për t'u informuar lidhur me procesin e vaksinimit të qytetarëve të Drenasit.

Gjatë qëndrimit në qendrën e vaksinimit kryetari

Lladrovci ka parë nga afër se vaksinimi është duke shkuar mirë, por ka thënë se kjo nuk është e mjaftueshme dhe u ka bërë thirrje qytetarëve të Drenasit që të vaksinohen për të mbrojtur veten, familjen dhe rrethin. “Vaksinimi është rruga e mbrojtjes së qytetarëve tanë. Këtë e kanë thënë institucionet tona relevante dhe ne insistojmë që këto rekomandime të zbatohen. Vaksina ka të mjaftueshme,

vende për vaksinim po, personel shëndetësor që kryen vaksinimin po, çfarë duhet pritur”, ka thënë Lladrovci, duke shtuar se mbrojtja më e mirë është vaksinimi. “Askush nuk duhet të pësojë nga pakujdesia juaj. është shumë brengosëse se varianti i ri i virusit ‘Delta’ po përhapet shumë shpejt dhe po i prek edhe fëmijët, prandaj vaksinohuni”, ka thënë Lladrovci.



## Një muaj paraburgim për Dardan Krivaqën

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**FERIZAJ, 25 GUSHT** - Gjykata Themelore në Ferizaj ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore të Ferizajt për caktimin e masës së paraburgimit kundër Dardan Krivaqës për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vrasje e rëndë. Sipas njoftimit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit për Krime të Rënda, Ibrahim Idrizi, ka vlerësuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë, se i pandehuri më 22 gusht 2021, në Ferizaj, në banesën e tij, me dashje dhe në mënyrë mizore për motive të ulëta, një natë përpara, ka ushtruar fillimisht dhunë psikike, pastaj edhe dhunë fizike, e cila ka

vazhduar edhe ditën kritike derisa e ndjera ka ndërruar jetë. Ndërsa i pandehuri A. S. gjatë gjithë kohës ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, e i cili edhe ka marrë pjesë në ushtrimin e dhunës fizike dhe psikike, me këtë ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e veprës penale, gjegjësisht vdekjen e të ndjerës, më pas të njëjtën e dërgojnë dhe e lënë në spitalin e përgjithshëm në Ferizaj, pa shenja jete, ndërsa dy të pandehurit ikin në drejtim të panjohur.

Po në këtë njoftim theksohet se gjyqtari i procedurës paraprake kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit e ka aprovuar si të bazuar konform dispozitave të KPPRK-së dhe i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaj.



Sipas vlerësimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, qëndrojnë arsyet ligjore për caktimin e paraburgimit të parapara në nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i KPPK-së, nga

fakti se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet.

## Përurohet kompleksi 'Kodra e UÇK-së' në Ngucat



**MALISHEVË, 25 GUSHT (ER)** - Në fshatin Ngucat të Komunës së Malishevës është bërë përurimi i kompleksit "Kodra e UÇK-së" e cila, mes të tjerash, ka të

ndërtuara shkronjat UÇK, në shenjë nderimi për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së dëshmorëve dhe veteranëve të luftës.

Përurimi i këtij kompleksi është bërë të mërkurën në 23-vjetorin e rënies së komandant "Kumanovës" dhe dëshmorëve të tjerë, emrin të cilit e ka

mbajtur Brigada 121 e ZO të Pashtrikut të UÇK-së. Fillimisht janë bërë nderime dhe homazhe në varrezat e dëshmorëve të Brigadës 121

"Ismet Jashari-Kumanova" në Kleçkë dhe në vendin e rënies së "Kumanovës", më pas, me një ceremoni të organizuar, është bërë edhe përurimi i kompleksit "Kodra e UÇK-së" ku, krahas shumë veteranëve të luftës dhe qytetarëve, morën pjesë edhe Rifat Jashari, Fatmir Limaj, gjeneral Kudusi Lame dhe gjeneral Gëzim Hazrolli, nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, kryetarë të komunave të tjera të vendit, përfaqësues të OVL të UÇK-së, liderë politikë lokalë dhe të tjerë.

Në ceremoninë e përuimit të kompleksit "Kodra e UÇK-së" fjalë rasti kanë mbajtur Rifat Jashari, Fatmir Limaj, Kudusi Lame, Metush Kryeziu dhe koordinatori i ndërtimit të kompleksit, Mustafë Shala.

Të gjithë folësit ndërtimin e këtij kompleksi e kanë vlerësuar vepër e madhe historike, në kujtim dhe nderim të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së popullit shqiptar në luftë për liri.

## Kryetarja e Gjykatës Speciale viziton Kosovën më 7 shtator

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova dhe administratorja Fidelma Donlon do ta vizitojnë Kosovën më 7 shtator.

Në një komunikatë të Dhomave të Specializuara thuhet se Trendafilova dhe Donlon do të flasin për mandatin, punën dhe

zhvillimet e fundit në Dhomat e Specializuara të Kosovës. "Takimi ndërveprues shënon fillimin e një angazhimi të shtuar të kryetares dhe të administratores në veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimin të DHSK-së. Duke pasur parasysh rregulloret

e shëndetit dhe të sigurisë si rezultat i pandemisë globale Covid-19, kryetarja dhe administratorja po shfrytëzojnë mundësinë e parë për të udhëtuar në Prishtinë për t'u takuar me shoqërinë civile dhe të tjerët", thuhet në komunikatën për media.



# Qeveria ndan mbi 40 milionë euro për zbatimin e masave të pakos së ringjalljes ekonomike

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, në mbledhjen e 31-të të qeverisë, ka propozuar ndarjen e 40.13 milionë euro për implementimin e masave nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike. Mjetet në fjalë ndahen në katër kategori të pakos, përkatësisht masa 1 (Mbështetja e punësimit), masa 2 (Ringjallja e ekonomisë dhe prodhimit), masa 3 (Mbështetja e familjes) dhe masa 4 (Mbështetja për publikun).

Përmes masës 1 (Mbështetja e punësimit), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve synon krijimin e vendeve të reja të punës, duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punëkërkuessit. Në

zbatim të kësaj mase janë ndarë mjete në vlerë prej 15 milionë eurosh për masën 1.1 - Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, masën 1.2 - Mbështetja për të punësuarit e formalizuar, dhe masën 1.3 - Mbështetja e punësimit të grave. Në këtë mbledhje të qeverisë është thënë se pandemia ka nxjerrë në pah rëndësinë e punës së deklaruar dhe pagesës së rregullt të kontributeve pensionale, si dhe nënpërfaqësimit e grave në tregun e punës. "Andaj, duke synuar ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, zbatimi i këtyre masave do të ketë një rëndësi kyçe në formalizim dhe rritje ekonomike. Vlen të theksohet se afati i aplikimit për masën 1.1, 1.2 dhe 1.3 bëhet në mënyrë elektronike përmes

platformës EDI të ATK-së dhe do të jetë i hapur deri më 15 tetor 2021", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Në zbatim të masës 2.1 (Subvencionimi i kredive investive), qeveria ndau 10.43 milionë euro për subvencionimin e kredive investuese të bizneseve prodhuese e përpunuese. Kjo masë ka për synim rritjen e investimeve të reja në zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve, e cila rrjedhimisht ndikon edhe në rritjen e punësimit dhe eksportit. Gjithashtu, duhet cekur se këto mjete janë siguruar nga emetimi i "Bonove të Diasporës", instrument financimi ky që ka pasur për qëllim kanalizimin e kapitalit të diasporës drejt investimeve për ndërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit. Ndërkaq përmes masës 3

(Mbështetja e familjes), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve synon krijimin e një shoqërie të barabartë dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve në vendin tonë. "Për këtë arsye, në zbatim të kësaj mase janë ndarë mjete financiare në shumën prej 12 milionë euro për masën 3.1 (Mbështetja për familjet) që kanë humbur familjarin, masën 3.4 (Kuponë ushqimi për familjet në nevojë), dhe masën 3.5 (Pagesa për lehonat dhe shtesat për fëmijë). Përgjithësisht, masa 3 paraqet një hap jetik në përpjekjet tona për zbutjen e varfërisë, si dhe ndihmën ndaj familjeve që kanë humbur më të dashurit në luftën me virusin Covid-19", ka njoftuar kjo ministri.

Së fundi, në zbatim të masës 4.1 u ndan 2.7 milionë euro si mbështetje e stafit mjekësor në

sektorin publik me pagë shtesë prej 10-përqindësh të pagës së rregullt bruto, jo më pak se 60 euro, për muajt gusht, shtator dhe tetor të vitit 2021.

Zbatimi i kësaj mase është tejet i rëndësishëm në vazhdimin e luftimit të pandemisë, veçanërisht tani kur vendi është në fazën e vaksinimit masiv. "Deri më tani MFPT ka marrë vendime për operacionalizim dhe ndarjen e mjeteve financiare për një sërë masash nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë reflektojnë objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe planit qeverisës 2021-2025. Së shpejti, MFPT do të vazhdojë shpalljen e kriterëve për operacionalizimin e masave të tjera të pakos", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.



## ENA dhe Akademia Diplomatike organizojnë trajnim për diplomaci ekonomike dhe publike

**PRISHTINË, 25 GUSHT (ER)** - "Trajnimi i bashkorganizuar nga ENA franceze dhe Akademia Diplomatike e Kosovës është një mundësi e mirë që diplomatët e Kosovës të mësojnë nga përvojat më të mira franceze në fusha me rëndësi si ekonomia dhe marrëdhëniet me publikun. Bashkëpunimet e tilla thellojnë tutje marrëdhëniet bilaterale", ka thënë Kreshnik Ahmeti, zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ambasadorja e Francës në Kosovë, Marie-Christine Butel, ka thënë se i gëzohet faktit që ENA dhe Franca mund të kontribuojnë në përforcimin e aftësive dhe trajnimin e diplomatëve të Kosovës. Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë Diplomatike, Sabri Kiçmari, ka vlerësuar lart bashkorganizimin e këtij trajnimit me ENA-n dhe ambasadën franceze, edhe në kushtet e pandemisë. "Në të ardhmen do të shohim edhe më

shumë aktivitete e shkëmbime të përbashkëta me Francën", ka deklaruar Kiçmari.

Ambasada e Francës, Shkolla Kombëtare e Administratës (ENA) dhe Akademia Diplomatike e Kosovës kanë organizuar dy ditë trajnim dhe shkëmbim mes diplomatëve të Kosovës dhe ekspertëve të ENA-s, më 24 dhe 25 gusht.

Ky aktivitet dyditor u zhvillua në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Akademisë Diplomatike dhe ENA-s,



nënshkruar në vitin 2016. Kjo marrëveshje strukturon bashkëpunimin e ndërsjellë,

veçanërisht kontributin në fushën e trajnimit të diplomatëve të Kosovës.





# VALLËZIM ME VIRUSIN. EVOLUCIONI 'I MIRË' I COVID ËSHTË FANTAZI: NA SHPËTON VETËM VAKSINA

Teksa kemi mbërritur në fundin e pushimeve, me virusin që, në përgjithësi, është kontrolluar në mënyrë të denjë deri më tani nga vaksinat, pavarësisht variantit Delta, është koha për të kuptuar se si mund të jetë vjeshta, që të jemi të paktën mendërisht, të përgatitur për atë që mund të ndodhë. Këto janë kohë të çuditshme, parashikueshmëria e të cilave është shumë më e ulët se zakonisht; ndaj është më mirë të shohim gjithçka pak nga lart dhe pak nga larg, pa u ndalur të gjurmohet skenarë shumë të detajuar, sepse numri i mundësive që ndryshojnë tek detajet, është tej mase i lartë. Le të fillojmë me një lajm të mirë: këtë vjeshtë do ta përballojmë me një përqindje të lartë të popullsisë së vaksinuar. Ata që flasin keq për vaksinat aktuale nuk kuptojnë disa gjëra shumë të thjeshta: nga njëra anë, numrin e infeksioneve, shtrimeve në spital dhe vdekjeve që ne i kemi shmangur tashmë në muajt e fundit, falë vaksinave – një rezultat i ditur tani – dhe nga ana tjetër faktin që

vaksinat, edhe në të ardhmen e afërt, do të vazhdojnë të bëjnë një punë të shkëlqyer, qoftë edhe vetëm për të zvogëluar numrin e infeksioneve, shtrimeve në spital dhe vdekjeve. Ata që deklarojnë se nuk vaksinohen pasi nuk janë të sigurt për efikasitetin, po bëjnë një parashikim vetë-përbushës: vaksinat aktuale, kur të ketë kaluar koha e mjaftueshme, sigurisht që nuk do të funksionojnë aq mirë sa tani, për të njëjtën arsye që vaksinat e gripit të tre viteve më parë, nuk do të funksionojnë mirë këtë vjeshtë. Sepse, pasi kalon një kohë që disave u duhet “për të qenë të sigurt”, virusi ndryshon; dhe më pas do të duhet të përdoren vakcina të reja, dhe përsëri ata do të kërkojnë më shumë kohë për të vendosur, duke shtyrë kështu verifikimin e pamundur afatgjatë të një vaksine, e cila e humbet efektivitetin e vet në një kohë më të shkurtër, sesa koha që u duhet atyre për të pranuar provat e efikasitetit. Për fat të mirë, shumë njerëz janë vaksinuar; mes tyre, virusi

është përhapur shumë pak në të kaluarën, dhe sot për shkak të variantit të ri disi më shumë, por gjithnjë jo aq sa do përhapej, nëse nuk do të ishin vaksinuar; dhe kur infektohen gjithësesi për shkak të dikujt që nuk është vaksinuar, edhe nëse nuk janë të rinj problemi zgjidhet shpejt dhe pa dëme, pa u dashur të shtrohen në spital. Nga ana tjetër, këtyre lajmeve të mira u kundërvihen humbja graduale e efikasitetit të vaksinave gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh, dhe shfaqja e një varianti më infektues e ndoshta edhe më të rrezikshëm klinikisht (por kjo mbetet për t’u verifikuar), si dhe shpërndarja shumë e çbalancuar e vaksinave në botë, gjë e cila krijon një burim variacionesh të reja, falë qarkullimit të pashqetësuar të virusit në vendet e pavaksinuar. Më pas, rreziku vjen nga mbijetesat në këtë basen të madh variacionesh, e atyre që mund të anashkalojnë vaksinat, terapitë dhe të gjitha masat tona. Ne nuk do ta çrrënjosim këtë virus, jo në një afat të shkurtër

të paktën, as nuk mund të shpresojmë në goditje të paparashikuara të fatit dhe viruse të dobësuar, siç tregohet nga ajo që po ndodh, me variante që nuk janë aspak “më të mirë”, pavarësisht atyre që parashikuan pa prova ose me keqinterpretime të fakteve dhe teorisë, një përshtatje imagjinare të virusit në favorin tonë. Përkundrazi, ne duhet të përgatitemi për një vallëzim të gjatë: variante të reja, të cilat do t’i përballim me vaksinat e reja dhe (shpresojmë) ilaçet e para, por që do të shkaktojnë dëme dhe gjithashtu do të kërkojnë masa të përkohshme ngurtësimi dhe jo-farmakologjike; dhe periudha qetësie, madje edhe periudha të gjata, në të cilat virusi do të jetë epidemiologjikisht i fjetur. Është përsëritja e përrjetshme e “dialogut darvinian” mes nesh dhe parazitëve tanë: shfaqen lloje të reja, dhe për fat të mirë, ndryshe nga e kaluara, nuk duhet të presim që të krijohet imuniteti i popullatës me mbijetesën e vetëm të imunizuarve nga infeksioni,

por mund të përdorim teknologjinë aktuale për të provuar të japim goditje dhe të kufizojmë dëmin. Dhe duke qenë se pauzat në këtë dialog mes një bujtësi dhe parazitëve të tij mund të zgjasin me gjenerata, brezat e rinj mund të harrojnë patogenët, kështu që ekzistenca e tyre tronditet kur disa prej tyre rishfaqen në forma të reja më të përshtatura (në kuptimin darvinian, jo të Disney-t). Ndoshta është koha ta shohim në sy realitetin: ne nuk jemi të vetmit në këtë planet, as speciet e tjera nuk ekzistojnë për ne, kështu që mbijetesat jonë, me shëndet të mirë dhe në kushtet më të mira të lirisë varet nga aftësia jonë për t’u përballur me parazitët duke përdorur teknologjinë tonë, dhe jo duke imagjinuar se asnjë infektion nuk është aq i rëndë, apo që pandemitë janë shpikje e dikujt tjetër. Në fund të fundit, ne nuk krijojmë muzikën me të cilën do të duhet të kërcëjmë, por përzgjedhjen darviniane që vepron mbi parazitët tanë. / Enrico Bucci (Il Foglio)/Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Krasniqi: E kemi harruar barazimin me Malishevën, për fitore ndaj Ballkanit

Mbrojtësi i FC Prishtina, Besnik Krasniqi, ka bërë me dije për “Epokën e re” se klubi kryeqytetas e ka harruar tashmë barazimin ndaj Malishevës dhe është gati të marrë tri pikët ndaj Ballkanit në fundjavë. “Duhet ta harrojmë ndeshjen e parë dhe të fokusohemi në ndeshjen e dytë. Jemi mjaft të motivuar për të dielën. Na pret një skuadër e fortë siç është Ballkani. Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje dhe nëse luajmë siç dimë ne, atëherë do ta arrijmë edhe fitoren”, ka thënë Krasniqi

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Prishtina, nuk e nisi mirë edicionin e ri në Superligë, pasi barazoi vetëm në minutat shtesë ndaj skuadrës debutuese, Malishevës (1-1). Mbrojtësi Besnik Krasniqi, që është ndër lojtarët më të dalluar në klubin kryeqytetas, e ka përjashtuar mundësinë që lodhja të ketë ndikuar në këtë ndeshje, ani pse Prishtina ishte pjesëmarrëse në ndeshjet ndërkombëtare dhe gjithashtu luajti në finale të Superkupës ndaj Llapit. “Nuk ndikoj pjesëmarrja në garat e Evropës, as ndeshja e Superkupës, por në futboll nuk del gjithmonë si mendon sepse luan edhe kundërshtari dhe mundësitë janë që e kemi marrë ndeshjen e parë më të lehtë dhe kemi menduar se fitojmë. Duhet të jemi më seriozë dhe ta japim maksimumin në secilën ndeshje për ta arritur synimin”,

ka deklaruar Krasniqi. Mbrojtësi Krasniqi të dielën me Prishtinën zhvillojnë derbin ndaj ish-skuadrës së tij, Ballkanit. Ai ka thënë se skuadra “bardhekaltër” në këtë ndeshje do ta shijojë fitoren. “Duhet ta harrojmë ndeshjen e parë dhe të fokusohemi në ndeshjen e dytë. Jemi mjaft të motivuar për të

dielën. Na pret një skuadër e fortë siç është Ballkani. Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje dhe nëse luajmë siç dimë ne, atëherë do ta arrijmë edhe fitoren”, ka thënë Krasniqi. Skuadra e Prishtinës edhe në këtë edicion është ndër favoritët kryesorë për titullin e kampionit, por favorite është

### Ahmed Januzi dënohet me dy ndeshje moslojë

Komisioni Disiplinor i shkallës së parë shqyrtoi procedurat e iniciuara disiplinore nga ana e Komisionit të Garave pas përfundimit të ndeshjeve të javës së I-të të Superligës së Kosovës në futboll për kategorinë e sendorëve. KD mori vendim që futbollisti i KF Dukagjini nga Klina, Ahmed Januzi të dënohet me dy ndeshje moslojë. “Futbollisti i KF Dukagjini nga Klina, Ahmed Januzi, me numër të fanellës 27 dhe ID 000635M88, në ndeshjen e javës së parë, ndërmyjet Ballkani – Dukagjini, e zhvilluar në Suharekë më 21.08.2021, në minutën 87, pas një ndërhyrje të rrezikshme ndaj lojtarit kundërshtar, gjyqtari e ndëshkon me karton të kuq direkt. Dënohet me ndalesë lojë për 2 (dy), ndeshje zyrtare, sipas radhës, të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës”, thuhet në njoftimin e FFK-së.



edhe në garën e Kupës për faktin se gjatë verës ka mbajtur pjesën më të madhe të lojtarëve kryesorë dhe ka bërë disa transferime cilësore. Futbollistët që kanë “aterruar” gjatë kësaj vere në stadiumin

“Fadil Vokrri” janë: Xhevdet Shabani, Mendurim Hoti, Bleart Tolaj, Kristian Vangjeli, Florent Avdyli, Arlind Shabani, Betim Halimi, Olti Mehmeti, Sodik Ololande Atanda dhe Benet Ismaili.

## KB Prishtina përforcohet me vëllezërit Zeqiri

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - KB Prishtina ka vazhduar edhe të mërkurën transferimet, me synim që të rikthehet aty ku ishte para disa vjetëve, në majat e basketbollit të Kosovës. Prishtina ka zyrtarizuar transferimin e dyshes Lejson dhe Jetmir Zeqiri. “Vëllezërit Lejson e Jetmir Zeqiri edhe zyrtarisht pjesë e klubit më të madh basketbollistik shqiptar Sigal Prishtina. Sot në zyrat e klubit presidenti Burim Maraj së bashku me drejtorin e klubit, Edmond Azemi, nënshkruan kontratat me basketbollistët Lejson e Jetmir Zeqiri. Lejsoni është pjesë e kombëtares së



Maqedonisë Veriore. Jemi shumë të lumtur që kemi talentet shqiptarë nga Maqedonia e Veriut për këtë sezon”, thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

## Shaqiri: Do të më mungojnë tifozët e Liverpoolit dhe ‘Anfieldi’

**LIVERPOOL, 25 GUSHT** - Xherdan Shaqiri është larguar nga Liverpooli pas tre vjetësh të suksesshëm, ku fitoi Ligën e Kampionëve dhe Premierë Ligën, duke e bërë shqiptarin më të titulluar me trofe evropian. Stacioni i tij i radhës është Olympique Lyon, që e bleu për 12 milionë euro. Shaqiri e ka përshëndetur Liverpoolin dhe tifozët me një postim të shkurtër, por plot dashuri në “Instagram”. “Tifozë të dashur dhe Liverpool FC, do të më mungoni! Ju dhe ky klub i veçantë me stadiumin e mrekullueshëm ‘Anfield’. Ju faleminderit për gjithë mbështetjen tuaj!



Gjithë të mirat! Qëndroni të sigurt. Xherdani”, ka shkruar Shaqiri i cili ka luajtur edhe për Stoke Cityn, Interin, Bayern Munchenin dhe Baselin.

## Liçeni kalon në ‘Main Round’ të Ligës së Kampionëve

**PRISHTINË, 25 GUSHT** - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Liçeni, është kualifikuar në “Main Round” të Ligës së Kampionëve. Skuadra nga Drenasi në ndeshjen e fundit dhe

vendimtare në grup në fazën parakualifikuese e ka mposhtur skuadrën gjermane Weilimdorf me rezultat 3-2. Me 9 pikë nga tri ndeshje, Liçeni përfundoi në vendin e parë dhe

do t'i vazhdojë garat në garën elitare në fazën e njohur si “Main Round”. Shorti për këtë fazë do të tërhiqet më 30 gusht, kurse ndeshjet zhvillohen prej 26 deri më 31 tetor.



## Scott: Wilderi do t'i shkaktojë një humbje të dhunshme Furyt

TUSCALOOSA, 25 GUSHT - Deontay Wilder do t'i mjaftojnë 5 raunde për t'i shkaktuar një humbje të turpshme dhe të dhunshme Tyson Furyt. Këtë mendim ka shprehur trajneri i Wilderit, Malik Scott, në një intervistë për "Sky Sports". "Wilder ka kaq kohë që e pret këtë sfidë, këtë shans dhe

mezi pret të hakmerret ndaj Furyt. Ai është një boksier kaq vulnerabël, që do të shpërthejë në ring", ka thënë Malik. "Në ditën e tij më të mirë Fury është një boksier i mirë, por jo i pamposhtur. Deontay i sotëm e mund atë të vjetrin brenda dy raundeve. Sot ai është 10 herë më shumë i fokusuar, është

stërvitur 100 herë më fort. Ky është një kamp stërvitor i dhunshëm për Wilderit", ka shtuar trajneri i tij, Malik Scott paralajmëron Furyt: "Ky do të jetë versioni më i mirë i Wilderit që keni parë ndonjëherë. Këtë herë ai do të triumfojë dhe ju garantoj se Wilderi do ta mposhtë Furyt brenda 5 raundesh".



## Fazliu: Disa klube e fillojnë garën për titull, e përfundojnë në mesin e tabelës

GJILAN, 25 GUSHT - Një ndër lojtarët që shkëlqeu me Dritën në garat evropiane është Astrit Fazliu. Sulmuesi ka deklaruar për gazetën "Sheshi" se synimet e tij personale nuk ndryshojnë asnjëherë nga viti në vit, pasi ai gjithmonë synon që të ketë sukses si ekip dhe t'i përmbushë kërkesat e klubit. "Synimet tona janë sikurse të çdo sezoni tjetër, të kemi sukses si ekip dhe t'i përmbushim kërkesat e klubit ashtu siç i kërkojnë, ku dihet se një ekip si Drita kërkon sukses maksimal", ka thënë Fazliu. 33-vjeçari ka thënë se ende është herët të flitet për titull, pasi disa skuadra e nisin për titull pastaj përfundojnë në mesin e tabelës. "Pas disa xhirove do të dihet saktë se cilat skuadra kanë potencial për kreun", ka shtuar Fazliu.



Për fund, Fazliu ka një premtim edhe për tifozët e klubit "Intelektualët". "Unë u premtoj tifozëve se do të jap më të mirën nga vetja dhe do të angazhohem maksimalisht", ka deklaruar ai. Astrit Fazliu ka luajtur nëpër skuadra të ndryshme nga Superliga e Kosovës sikurse Feronikeli, Drita, Ferizaj, Prishtina, Ulpiana etj.

## Berisha largohet nga Australia, mendon rikthimin në Evropë

GEELONG, 25 GUSHT - Besart Berisha i ka dhënë fund përvojës në futbollin australian. Sulmuesi nga Kosova e mbylli përvojën dyvjeçare me ekipin Western United pasi i skadoi kontrata. 36-vjeçari spekulohet se mund të rikthehet në Melbourne Victory, me të cilin e kishte fituar titullin e kampionit dy herë por, në fund, ky transferim nuk u realizua. Tash, ish-përfaqësuesi i Kosovës nuk e ka përjashtuar mundësinë që në fund të karrierës të luajë në futbollin evropian, me shumë gjasë në atë gjerman. "Unë jam 36 vjeç, por ndiej se mund të luaj edhe një sezon. Unë bisedova me klube, por në fund nuk ndodhi asgjë. Kështu që, mua më duhet të mendoj për të ardhmen", ka deklaruar Berisha për "The Age". "Ka mundësi të shkoj jashtë shtetit (Australisë) dhe nëse kjo mund të realizohet, do të doja shumë që kjo të ndodhë. Ta luaj sezonin tim të fundit aty ku nisa gjithçka (në Gjermani), për mua do të ishte speciale", ka shtuar sulmuesi veteran. Berisha i kaloi rreth 10 vjet në



futbollin australian, ndërsa e pati një përvojë të shkurtër në Japoni. Ai kishte shkuar në Australi në vitin 2011 dhe i kishte kaluar tre sezone në Brisbane Roar. Berisha e kishte ndihmuar këtë klub të shpallej dy herë kampion dhe kishte shënuar në dy finalët e mëdha më 2012 dhe 2014. Më pas i ishte bashkuar klubit Melbourne Victory ku, po ashtu, kishte shënuar në finalen e madhe ndaj Sydneyt në vitin 2015. Berisha e kishte fituar titullin e katërt të kampionit në Australi në vitin 2018 para se t'i bashkohej klubit japonez Sanfrece

Hiroshima. Më pas u rikthye në futbollin australian në ekipin Western në vitin 2019, duke i realizuar 26 gola në 50 paraqitje në A-League. Berisha do të largohet si golashënuesi më i mirë në histori të futbollit australian. Ai i ka realizuar 142 gola, 38 më shumë se rivali më i afërt, Jamie Maclaren. Krahas katër titujve të kampionit, Berisha ka fituar edhe trofe individuale gjatë përvojës së tij në Australi. Ai u shpall dy herë golashënuesi më i mirë i ligës. Berisha ka luajtur për kombëtaren shqiptare dhe për Kosovën.

### SHKURT

#### Flick: Refuzova dy klube të mëdha për Gjermaninë

Hansi Flick ka folur për largimin nga Bayern Muncheni dhe refuzimin e dy klubeve të mëdha për të nënshkruar me Kombëtaren e Gjermanisë. Trajneri gjerman po përgatitet për ta nisur përvojën si trajner i kombëtares gjermane në shtator. "Para se të firmosja me Federatën Gjermane, bëra dy video-telefonata me dy klube shumë të njohura ndërkombëtare, të cilat ishin të interesuara për të më ofruar postin e trajnerit. Me njërin prej tyre fola direkt me presidentin, i cili provoi të më ndryshojë mendje, por doja patjetër stolin e kombëtares", ka thënë Flick.

#### Ronaldo braktisi stërvitjen për shkak të lëndimit

Pasi e filloi ndeshjen e parë zyrtare të sezonit të ri në Udine nga stoli, Cristiano Ronaldo gjithashtu mund ta humbasë ndeshjen e dytë të Juves në Serinë A, atë kundër Empolit. Fenomeni portugez, rreth të cilit në orët e fundit janë ngritur shumë hipoteza joreale për largimin nga bardhezinjtë, në fakt ka anashkalluar pjesën e dytë të stërvitjes e së mërkurës, atë të ndeshjes në fushë. Pra, e ka zvogëluar kohën e trajnimit për shkak të një goditjeje që mori në krah gjatë një dyluftimi loje me Alex Sandro. I shoqëruar nga një anëtar i stafit jashtë fushës, CR7 arriti në dhomat e zhveshjes para shokëve të tij të skuadrës dhe në orët e ardhshme do t'u nënshtrohet kontrolleve të nevojshme për ta vlerësuar shkallën e goditjes së pësuar dhe për këtë arsye praninë ose jo kundër Empolit.

#### Kane: Nuk largohem nga Tottenham

Sulmuesi Harry Kane do të qëndrojë në Tottenham Hotspur. Lajmin e ka konfirmuar sulmuesi anglez i cili ishte i lidhur gjatë kësaj vere me një kalim te Manchester City. "Ishte e pabesueshme t'i shoh tifozët e Spursit të dielën dhe të lexoj disa nga mesazhet për mbështetjen që kam pasur javët e fundit. Do të qëndroj te Tottenham këtë verë dhe do të fokusohem 100 për qind që t'i ndihmoj skuadrës që të arrijë sukses", ka thënë Kane.

#### Bayerni, afër transferimit të Sabitzerit nga Leipzig

Bayern Munchen nuk ka bërë një merkato si të klubeve të Premierë Ligës, por gjithmonë është gati t'i shfrytëzojë mundësitë e tregut dhe të marrë yje, kryesisht të Bundesligas. Kështu do të ndodhë edhe me Marcel Sabitzer. Mesfushorit i skadon kontrata vitin e ardhshëm me Leipzigun dhe klubi është gati ta lërë të largohet që në këtë verë. Bayern Munchenit i duhen vetëm 10 milionë euro për ta blerë austriakun, që është një nga më të mirët në Gjermani në rolin e tij.

## Bastexhinjtë: Dy skuadra favorite për titullin e sezonit të ri në NBA

Sezoni i ri 2021-2022 në NBA do të nisë pas dy muajsh (19 tetor), por bastexhinjtë kanë nisur që tani të japin kuotat e para në lidhje me ekipet favorite për titull. Këtë sezon, sipas tyre, dy skuadra janë në

"pole" për titullin: Lakersat (Konferenca e Perëndimit) dhe Brooklyn Nets (Konferenca e Lindjes). Sipas bastexhinjve, këto dy ekipe do të dalin në finale e madhe "play-off", duke mos

përcaktuar dot më të mirën. Ardhja e Westbrook te Lakersat ka rritur kuotat e ekipit kalifornian. Në njërin kah janë LeBron-James-Westbrook dhe në kahun tjetër janë Durant-Irving-Harden, një sfidë

që pritet të dhurojë spektakël. Në vendin e tretë të skuadrave favorite për titull ndodhen kampionët në fuqi të Milwaukee Bucksit e pas tyre vijnë New York, Phoenix, Golden State dhe Utah Jazz.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES**  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 940/1  
Dt: 25.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vend i lirë/Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës (16 orë mësimore)	Vend i lirë
			Një (1) instruktor/e për lëndet teorike dhe praktike në profilin: Instalues elektrik (20 orë mësimore)	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvijës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.

- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvijës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvijën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

## >> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Mergim Asani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 941/1

Dt: 25.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## RI-SHPALLJE KONKURSI

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës (20 orë mësimore)	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Mikrobiologji dhe Imunologji (10 orë mësimore)	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftoheshin në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA –SUHAREKË  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



### Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

06-Nr- 1349

Me datë 23.08.2021

Në bazë të nenit 8 të pika 1 dhe 2 Ligjit të punës Nr- 03/L-212, kërkesës së DSHMS me nr.prot. 01-Nr-104-46685 të datës 10.08.2021 dhe sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës, 01- Nr. 016- 48881 të datës 16.08.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit punës: Stomatolog i praksës përgjithshme: në QKMF në Suharekë

Institucioni: Komuna e Suharekës

Departamenti/ Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - QKMF

Lloji i pozitës: Mjek Stomatolog

Numri i pozitave: (1) Një

Titulli i mbikqyrësit: Shefi i Shërbimit Stomatologjik

Kodi : H- 26

Grada/Koeficienti: 7.2

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

#### Kushtet e përgjithshme dhe të veqanta për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi të plotë për të vepru, të zotërojë njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për gjuhët
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje
- Të mos ketë në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e stomatologut.

- Kryen punet profesionale të nderlidhura me shërbimin polivalent
- Bene shërimin, kiretazhin si dhe ekstraksionin e dhembëve
- Kryen të gjitha procedurat mjekuese urgjente : ndalja e dhimbjes, drenazha, largimi i ures, incizione, referime për shërim, ekzaminim diagnostike shtese
- Përkruan barerat dhe percjell gjendjen e pacienteve.
- Percjell edukimin e mjekëve dhe kuadrit të mesëm mjekësorë në praktiken profesionale obligative
- Bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësorë

#### Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të ketë të kryer fakultetin e mjeksisë, drejtimi i stomatologjisë i përgjithshëm
- Licencën perkatese të lëshuar nga organi kompetent

#### Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezumeja personale ( CV)
- Dokumenti personal ( Leternjoftimi apo Pasaporta), fotokopje
- Diploma e kualifikimit
- Kopjet e Licensës
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar nga MASHT
- Certifikata që nuk jeni nën hetime ( Originali )
- Certifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga Komisioni

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga publikimi në mjetet e informimit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe  
Mirëqenie Sociale  
Ma.Sc. Besa KUQI



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA –SUHAREKË  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu

06-Nr. 1349

Datum: 23.08.2021

Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, Zahteva DZSZ Br. pr.01.- br. 104-46685 dana: 10.08.2021 i ovlašćenja Predsednika Opštine, 01-Br.016-48881 dana 16.08.2021, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:

### KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: Stomatolog Opšte Prakse u Glavni Center Porodice Medicine Suva Reka

Institucija: Opština Suva Reka

Odel/Uprava: Uprava za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje-GCPM

Vrsta pozicije: Lekar, Stomatolog

Broj pozicija: (1) Jedan

Naziv nadzornog : Shef Stomatoloske Sluzhbe

Nivo/Koeficijent: 7.2

COD H-26

Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

#### Opšti i posebni uslovi za prijem javnih službenika:

- Da bude državljanin Republike Kosovo
- Da imam punu sposobnost delovanja
- Da vlada jednim od službenih jezika, u skladu sa zakonom o jezicima
- Da bude zdravstveno sposoban za izvršavanje odgovarajućeg zadatka
- Da ne bude osuđen sa pravosnažnom odlukom da je namerno počinio krivično delo
- Da nema na snazi nijednu disciplinsku meru za uklanjanje sa položaja javnog službenika, razrešenog u skladu sa zakonom.

#### Dužnosti i odgovornosti Stomatologa Opšte Prakse:

- Obavlja profesionalni posao u vezi sa polivalentnim uslugom:
- Vrsi zarastanje kiretazu i vadenje zuba
- Obavlja sve hitne medicinske postupke: ublazavanje bola, drenazu, uklanjanje mosta, rezove, pretlaze dijagnostičke preglede
- Opisuje lekove i prati stanje pacienata
- Prati obrozovanje lekara i sekundarnog medicinskog osoblja u obaveznju profesionalnoj praksi
- Saraduje sa drugim zdravstvenim radnicima sa zajedničkim cilijem pružanja zdravstvene zastite

#### Uslovi i kriteriji za izbor kandidata:

- Da je završio Medicinski Fakultet smer Opsteg Stomatologa
- Relevantna Licenca izdata od nadležnog organa

#### Potrebni dokumenti:

- -Popunjen obrazac za prijavu
- - Lična biografija (CV)
- - Lični dokument (lična karta ili pasoš), fotokopija
- - Diploma o kvalifikaciji
- - Kopije licence
- - Za osobe koje su diplomirale van Kosova potrebna je nostrifikacija diplome od strane MONT-a
- - Potvrda da niste pod istragom (original)
- Lekarsko uverenje nako Dokumenti moraju biti u kopiji i neće se vraćati, dok će u slučaju intervju biti potrebni originali.

Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkciji za Zdravstvo u Suvoj Reci. Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevni sredstvima javnog informisanja.

Direktor Direkcije, OCPM  
Ma.Sc. Besa KUQI



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

